

K E R K E S E

**PER LESHIMIN E URDHERIT PER KRYERJEN E PROCEDURES SE LIRIMIT TE
TE DENUARIT DRITAN HASAN DAJTI.**

Drejtuar: DREJTORIT TE I.E.V.P. PEQIN
Z. Florenc Doka

Kerkues: **Dritan Dajti**, aktualisht duke vuajtur denimin me burgim prane I.E.V.P. Peqin, perfaqesuar nga av.**Alban Kapxhiu**.

Objekti:

1. Leshimi i urdherit per kryerjen e procedures se lirimit te te denuarit Dritan Hasan Dajti, per shkak se ai ne date 04.07.2024, perfundon ekzekutimin e vendimit te denimit me 25 vjet burgim.
2. Pajisjen e te liruarit Dritan Dajti **me një vërtetim në të cilin saktësohen kohëzgjatja e vuajtjes së dënimit, uljet dhe përfitimet për shkak të ligjit, si dhe kohëzgjatja e lloji i punës së kryer në institucion.**
3. Lëshimin e vërtetimit me të dhëna për aftësimin profesional të fituar gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, si dhe **për qëndrimin dhe sjelljen e tij brenda institucionit.**

Baza Ligjore: Neni 30 i LIGJ Nr. 79/2020 PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE dhe Neni 79 i LIGJIT Nr. 81/2020 PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM.

Me 30 Prill 2024, Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Elbasan, me Vendim Nr.739/13-2024-2032, ka vendosur uljen e denimit per te denuarin Dritan Dajti ne masen 43 dite. Ne faqen 2 te ketij vendimi, ne Kapitullin II, thuhet:

Së pari, me vendimin Nr.1108/13/2020/2020, datë 11.05.2020 gjykata e Shkallës së Parë e Elbasan ka vendosur bashkimin e dënimeve të dhëna për të dënuarin Dritan Dajti, në një denim të vetëm me 25 njëzet e pesë vite burgim; konkretisht bashkimin e denimit me 25 vjet burgim dhene me vendimin Nr.13, datë 08.02.2011 të gjykatës së parë për krimet e vënda, me denimin 23 vjet burgim dhene me vendimin Nr.146 i kti date 1/03.2006, te gjykates se rethit gjyqesor irane. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët, me datë 26.05.2020.

Së dyti, nga përmbajtja e shkresës "Dinamika e vuajtjes së dënimit për të dënuarin" rezulton se nga data e arrestimit, datë 0/08.2001, deri më datë 30.04.2024 i dënuari ka vuajtur gjithësej 24 njëzet e katër vjet, 8 tete muaj e 13 trembëdhjetë ditë.

Sa sipër, Kërkesa për leshimin e urdherit për kryerjen e procedurës së lirimit të të dënuarit Dritan Dajti lidhet drejtpërsdrejti me detyrimin ligjor që ka **Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin**, për të zbatuar Vendimin Nr.739/13-2024-2032, date 30.04.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, e cila ka vendosur uljen e denimit për Dritan Dajtin në masën **43 dite**.

Ky vendim ka marrë formë të prerë sot në datën 04.07.2024, dite kur sipas llogaritjeve dhe vlerësimit të deklaruar nga vete gjykata në këtë vendim, Dritan Dajti përfundon kryerjen e denimit me 25 vjet burgim.

Në këto kushte, mbështetur në observimet dhe argumentet e parashtruara, si dhe bazuar në Nenin 30 të LIGJIT Nr.79/2020 PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE dhe Nenit 79 të LIGJIT Nr.81/2020 PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM, ku respektivisht thuhet:

Dënimi me burgim vlerësohet i plotësuar dhe i dënuari lirohet kur përfundon kryerjen e dënimit. ... Procedura e lirimit kryhet nga institucioni i ekzekutimit të vendimit penal.

irimi i të dënuarit bëhet kur përfundon ekzekutimi i vendimit të dënimit ose, në bazë të ligjit, me vendim të organit kompetent. Personeli i institucionit kryen veprimet bazuar në urdhrin me shkrim të drejtorit të institucionit;

stitucioni i ekzekutimit të vendimeve penale pajis të liruarin me një vërtetim në të cilin saktësohen kohëzgjatja e vuajtjes së dënimit, uljet dhe përfitimet për shkak të ligjit, si dhe kohëzgjatja e lloji i punës së kryer në institucion;

Me kërkesën e të liruarit, institucioni mund të lëshojë vërtetim me të dhëna për aftësimin profesional të fituar gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, si dhe për qëndrimin dhe sjelljen e tij brenda institucionit;

K e r k o j m e :

1. Lëshimin e urdherit për kryerjen e procedurës së lirimit të të denuarit Dritan Hasan Dajti, për shkak se ai në datë 04.07.2024, përfundon ekzekutimin e vendimit të dënimit me 25 vjet burgim.
2. Pajisjen e të liruarit Dritan Dajti **me një vërtetim në të cilin saktësohen kohëzgjatja e vuajtjes së dënimit**, uljet dhe përfitimet për shkak të ligjit, si dhe kohëzgjatja e lloji i punës së kryer në institucion.
3. Lëshimin e vërtetimit me të dhëna për aftësimin profesional të fituar gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, si dhe **për qëndrimin dhe sjelljen e tij brenda institucionit.**

Tirane me 04 Korrik 2024.

**I DENUARI
DRITAN DAJTI**

AV. ALBAN KAPXHIU